



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 562, datë 20.11.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË PRANË GJYKATËS SË
POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR
POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.91, DATË 26.02.2020, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 90 dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86, në pikën 3, të nenit 97 dhe në nenin 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi konstatoi tërheqjen e kandidatëve nga procedura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr.91, datë 26.02.2020, duke vlerësuar se objekti për të cilin kjo procedurë ka nisur është bërë i pamundur, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR